



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor

Nr. Prot: 715

Prof. dr. Marjan Dema

Datë: 15.3.2018

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 01.03.2018, mori këtë


V E N D I M

- I. Miratohen listat e studentëve të ranguar në programet përkatëse nga njësitë akademike sipas kriterëve të konkursit publik për regjistrim të studentëve në studimet e doktoratës në Universitetin e Prishtinës.
- II. Miratimi i listave bëhet në bazë të rezultateve të shpallura nga ana e fakulteteve përkatëse dhe njoftimit me kandidatët e pranuar.
- III. Regjistrimi i studentëve si në pikën I të këtij vendimi fillon nga viti akademik 2017/18.
- IV. Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar bëhet nga data **19. 03. 2018** deri më **23. 03. 2018** në Administratën Qendrore të Universitetit (ndërtesa e Bibliotekës Universitare).
- V. Kandidatët e pranuar, për regjistrim duhet të paraqesin:
 - Fletëregjistrimin e plotësuar (i cili merret në Administratën Qendrore të UP-së, aty ku bëhet regjistrimi);
 - Dy fotografi të formatit 6x4 cm dhe
 - Fletëpagesën (e cila shkarkohet nga interneti). Pagesa bëhet në njërin prej bankave afariste.
- VI. Bashkëlidhur me këtë vendim janë pasqyrat me propozimet e njërive akademike.

Këshillë juridike: Kandidatët e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojnë ankesë në Komisionin për ankesa dhe parashtresa ndaj vendimeve të Senatit të UP-së në afat prej 8 ditësh nga koha e shpalljes së këtij vendimi në ueb faqen e Universitetit.

Ky vendim u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Shërbimit për çështje të studentëve;
3. Zyrës për çështje akademike;
4. Zyrtarit ligjor të UP-së dhe
5. Fakulteteve.



REKTORI,

Prof. *Marjan Dema*
Marjan Dema